



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

 Zyra e Guvernatorit Kabinet Guvernora Governor's Office	
E Dërguar: Predator: Send to: DPPP	
Delet: Destur: Drita:	Nr: Br: No: 03.05.24 / 293-D-24

Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, nenin 85, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, neni 4, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L-045 për Sigurimet, neni 23, paragrafi 6, si dhe nenin 66 paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 3 maj 2024, miratoi këtë:

UDHËZIM

MBI POLITIKAT DHE PROCEDURAT PËR MENAXHIMIN EFEKTIV TË RREZIKUT TË PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT (PP/FT) GJATË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE FINANCIARE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi është të përcaktojë politikat, procedurat dhe kontrollet që institucionet financiare duhet të vendosen për të menaxhuar në mënyrë efektive rrezikun nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit gjatë ofrimit të shërbimeve financiare.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky Udhëzim zbatohet për të gjitha bankat, institucionet financiare jobankare, duke përfshirë zyrat e këmbimit valutor, institucionet mikrofinanciare dhe siguruesit.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet në këtë Udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termet e përkufizuara në Rregulloren (e BQK-së) për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit dhe/ose me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e këtij Udhëzimi.
2. *De-risk* – nënkupton refuzimin për të krijuar marrëdhënie kontraktuale / biznese ose ndërprerjen e saj me klientët individualë (individ, biznese, organizata të huaja, etj.) ose kategoritë e klientëve të lidhur me rrezik më të lartë të PP/TF, ose për të refuzuar realizimin e transaksioneve me rrezik më të lartë të PP/FT, bazuar në një vlerësim individual të bërë nga autoriteti kompetent i institucionit financiar.
3. *KDK* – Kujdesi i duhur ndaj Klientit

Neni 4 **Vlerësimi i rrezikut**

1. Institucionet financiare në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe kërkesat e Rregullores (së BQK-së) për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, duhet të miratojnë politika dhe procedura në mënyrë që të mundësojnë identifikimin e faktorëve të rrezikut dhe vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të marrëdhënieve kontraktuale / biznese individuale. Si pjesë e kësaj, institucionet financiare duhet të bëjnë dallimin midis rrezikut të lidhur me një kategori të caktuar të klientëve dhe rrezikut me klientët individualë që i përkasin kësaj kategorie.
2. Institucionet financiare duhet të sigurojnë që zbatimimi i këtyre politikave dhe procedurave rezulton vlerësim individual i rrezikut, që nuk do të rezultojë me refuzime apo ndërprerje grupore të marrëdhënieve kontraktuale / biznese për kategori të caktuar të klientëve të cilët i kanë vlerësuar me rrezik të lartë të PP/FT. Refuzimi i tillë apo ndërprerja e marrëdhënies se tillë duhet të dokumentohet dhe argumentohet mjaftueshëm në dosjen e klientit, dhe mund të jetë subjekt i ekzaminimit nga BQK.
3. Refuzimi apo ndërprerja e marrëdhënies kontraktuale / biznese mbi bazën e rrezikut për kategori të caktuar të klientëve (segmente, status ligjor, apo tjetër) pa vlerësuar profilin e rrezikut individual, konsiderohet veprim i pa justifikuar dhe tregues i menaxhimit jo efektiv të rrezikut nga PP/FT. Kjo mund të konsiderohet se kufizon qasjen në financa, apo redukton konkurrencën në sistemin financiar.
4. Veprimet e institucioneve financiare në zbatimin e kërkesave të PPP/LFT duhet të jenë proporcionale dhe të bazuara në rreziqet specifike, duke mos tejkaluar qëllimet për sigurimin e pajtueshmërisë me kërkesat ligjore.
5. Kur institucionet financiare hasin në klientë të profilit të lartë të rrezikut nga vlerësimi individual apo kur transaksionet e kryera me institucionet financiare vlerësohen me rrezik të lartë, njoftohet edhe Divizioni përkatës në BQK.

5

6. Nëse subjekti në fjalë është vet institucioni financiar (jo bankar) që ka licencë nga BQK për operim dhe konsiderohet se nuk mund të hap llogari, duhet t'i mbyllet llogaria apo ndalohet transaksioni, si profil i klientit apo transaksion me rrezik të lartë, njoftohet menjëherë BQK.

Neni 5

Masat e Kujdesit të Duhur ndaj Klientit

1. Institucionet financiare duhet të vendosin politika dhe procedura të bazuara në rrezik për të siguruar që qasja e tyre në zbatimin e masave të kujdesit të duhur ndaj klientit nuk do të rezultojë në mohimin e padrejtë të klientëve për qasje në shërbimet financiare, duke mos respektuar edhe kontekstin lokal të rregullativës dhe ambientit ekonomik dhe ligjor.
2. Për të përmbushur detyrimet e kujdesit të duhur ndaj klientit të përcaktuara në Ligjin për PPP/LFT, institucionet financiare duhet të përcaktojnë kriteret që do të aplikojnë për të përcaktuar se mbi cilat arsye do të vendosin që një marrëdhënie biznesi mund të refuzohet apo të ndërprehet ose një transaksion mund të refuzohet të realizohet. Si pjesë e kësaj, institucionet financiare në politikat dhe procedurat e tyre duhet të përcaktojnë të gjitha opsionet e masave zbutëse të cilat konsiderohen të aplikohen për uljen e rrezikut të lartë të PP/FT para se të vendosin për të refuzuar klientët për shkaqe të rrezikut nga PP/FT. Këto masa zbutëse së paku duhet të përfshijnë nivelin dhe intensitetin e monitorimit si dhe aplikimin e kufizuar të produkteve dhe shërbimeve. Politikat dhe procedurat e institucioneve financiare duhet të përcaktojnë qartë se në cilat situata mund të jetë i përshtatshëm zbatimi i këtyre masave lehtësuese.
3. Institucionet financiare para se të marrin vendim për të refuzuar apo ndërprerë një marrëdhënie kontraktuale / biznese duhet të binden se kanë marrë në konsideratë të gjitha masat zbutëse të cilat mund të aplikohen në rastin konkret, duke marrë në konsideratë rrezikun e PP/FT të lidhur me marrëdhënien ekzistuese apo te mundshme të biznesit.
4. Institucionet financiare duhet të dokumentojnë çdo vendim individual për të refuzuar ose ndërprerë një marrëdhënie kontraktuale biznesi dhe arsyen për ta bërë këtë, dhe duhet të jenë të përgatitura për t'ia vënë këtë dokumentacion në dispozicion autoritetit të tyre kompetent sipas kërkesës.

Neni 6

Rregullimi i intensitetit të masave të monitorimit

1. Institucionet financiare duhet të përcaktojnë në politikat dhe procedurat e tyre mënyrën e rregullimit të monitorimit në përputhje me rrezikun e PP/FT të paraqitur nga klienti.
2. Politikat dhe procedurat e institucioneve financiare duhet të përmbajnë udhëzime për trajtimin e aplikacioneve nga klientët që mund të kenë arsye të besueshme dhe legjitime për të mos qenë në gjendje të ofrojnë forma tradicionale të dokumenteve të identifikimit. Këto duhet të përcaktojnë të paktën:



- 2.1. Hapat që duhen ndërmarrë kur klienti është një person që kërkon azil sipas Konventës së Gjenevës të 28 korrikut 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve, Protokollit të saj të 31 janarit 1967 dhe traktateve të tjera përkatëse ndërkombëtare, dhe nuk mund t'i sigurojë institucionit financiar një forma tradicionale e identifikimit, si pasaporta ose kartë identiteti. Në masën e lejuar me legjislacionin në vend, politikat dhe procedurat e institucioneve financiare duhet të përcaktojnë se në cilin dokument alternativ dhe të pavarur mund të mbështetet për të përmbushur detyrimet e tij të KDK-së. Këto dokumente duhet të jenë mjaftueshëm të besueshme dhe të jenë të njohura nga Institucionet e Republikës së Kosovës, d.m.th., të përditësuara, të lëshuara nga një autoritet zyrtar kombëtar ose lokal dhe të përmbajnë, të paktën, emrin e plotë të aplikantit dhe datën e lindjes.
- 2.2. Hapat që duhen ndërmarrë kur klienti nuk mund të sigurojë forma tradicionale të identifikimit ose një adresë, për shembull sepse klienti është refugjat sipas Konventës së Gjenevës 1951 ose traktateve të tjera përkatëse ndërkombëtare. Politikat dhe procedurat e institucioneve financiare duhet të specifikojnë se në cilin dokument alternativ dhe të pavarur mund të mbështetet. Në masën e lejuar me legjislacionin në vend, ky dokument mund të përfshijë dokumente identiteti të skaduar dhe dokumente të ofruara nga një autoritet zyrtar, si shërbimet sociale ose një organizatë jofitimprurëse e themeluar që punon në emër të autoriteteve zyrtare (Kryqi i Kuq ose të ngjashme), i cili gjithashtu ofron asistencë për këtë klient.

Neni 7

Qasja e kufizuar dhe e targetuar në produkte dhe shërbime

1. Politikat dhe procedurat e institucioneve financiare duhet të përfshijnë opsione dhe kriteret për rregullimin e veçorive të produkteve ose shërbimeve që i ofrohen një klienti të caktuar mbi një bazë individuale dhe të ndjeshme ndaj rrezikut.
2. Këto politika dhe procedura duhet të sigurojnë që kontrollet dhe procedurat e tyre specifikojnë se kufizimet e mundshme të produkteve dhe shërbimeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni zbatohen duke marrë parasysh situatën personale të individëve, rreziqet e PP/FT që lidhen me to dhe nevojat e tyre themelore financiare. Në këto raste, procedurat duhet të përfshijnë vlerësimin e opsioneve të mëposhtme për të zbutur potencialisht rreziqet e lidhura:
 - 2.1. të ofrojë llogari pagese me karakteristika bazë, sipas Rregullores (së BQK-së) për Qasje në Llogari Pagese me Shërbime Bazike;
 - 2.2. vendosja e kufizimeve për produktet dhe shërbimet financiare, të tilla si shuma, lloji ose numri i transfertave ose shuma e transaksioneve drejt dhe nga vendet e treta, veçanërisht kur këto vende të treta shoqërohen me rrezik më të lartë të PP/TF.
 - 2.3. Të mos vendosen tarifa që destimulojnë apo kufizojnë qasjen dhe përfshirjen në financa apo kufizojnë konkurrencën në sektor.

Neni 8
Dispozita kalimtare

1. Afati për përshtatjen plotësisht të bankave dhe siguruesve me kërkesat e këtij Udhëzimi është data 30.06.2024.
2. Afati për përshtatjen e institucioneve jo-bankare dhe institucioneve mikrofinanciare është 30.09.2024.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi më datën 7 maj 2024.



Ahmet Ismaili

Kryesues i Bordit Ekzekutiv